

BASHKIA TIRANË

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË  
AFATET E ANKIMIMIT

1. Drejtuar: Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “COMPANY RIVIERA 2008” shpk & “BAJRAMI N.” shpk
2. Adresa: “Rruga Nacionale Kamez-Fushe Kruje, Kthesa e Valiasit Nr.1, ne zone kadastrale 2066, Nr. Pasurie 62/38, Kamez Tirane” & “Labinot fushe Xibrake, rruga Elbasan-Xibrake km. 13, zk.3864, pasurite nr.734/1+732+738/9, Elbasan”.
3. Nipt: K81716011V & K02727202O
4. OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

5. OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ JO ☒

6. Tipi i Kontratës: Punime ndërtimi
7. Lloji i Procedurës së prokurimit: “Procedurë e Hapur”
8. Numri i Procedurës / referenca e Lotit: REF- 86395-05-21-2026
9. Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Rikualifikim urban i bllokut që kufizohet nga BLV. Bajram Curri- Blv. Petro N. Luarasi – Rruga Taulantia – Rruga Ali Demi – Faza II”.
10. Fondi limit: 445,392,143.33 (katërqind e dyzet e pesë milion e treqind e nëntëdhjetë e dy mijë e njëqind e dyzet e tre pikë tridhjetë e tre) pa TVSH.
11. Burimi i financimit: me burim financimi të ardhurat e Bashkisë Tiranë për vitin 2026, sipas VKB Nr.35, date 30.03.2026 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB Nr.100, datë 18.12.2025, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2026-2028 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2026”.
12. Kohëzgjatja e kontratës: 18 (tetëmbëdhjetë) muaj kalendarik.
13. Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 22.05.2026
14. Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike Nr. 33, datë 25.05.2026.

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim ☒

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “ALBAVIA” sh.p.k

NUIS J8152700Q

Vlera: 262,457,212.50 (dyqind e gjashtëdhjetë e dy million e katërqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e dymbëdhjetë pikë pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

**2. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “EUROKOS HOLDING SH.P.K DEGA NE SHQIPERI” sh.p.k & A.L-ASFALT” sh.p.k**

**NUIS K91727010A & NUIS K81511508A**

Vlera: 275,682,634.50 (dyqind e shtatëdhjetë e pesë million e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e tridhjetë e katër pikë pesëdhjetë) pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

**3. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “BE-IS” sh.p.k & “ERGI” sh.p.k & “RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN” sh.a**

**NUIS K71412003A & NUIS K02727229P & NUIS J62904264O**

Vlera: 279,026,097.00 (dyqind e shtatëdhjetë e nëntë million e njëzet e gjashtë mijë e nëntëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

**4. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “AGRI CONSTRUCTION” sh.p.k & “K A C D E D J A” sh.p.k**

**NUIS K01725001F & NUIS K51712017A**

Vlera: 296,516,879.40 (dyqind e nëndhjetë e gjashtë million e pesëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e nëntë pikë dyzet) lekë pa TVSH

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

**5. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “B93 II” sh.p.k & “ELMAZAJ KONSTRUKSION” sh.p.k & “ASI-2A CO” sh.p.k**

**NUIS L52209050O & NUIS L33229401T & NUIS K53002402C**

Vlera: 302,108,173.50 (treqind e dy million e njëqind e tetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë e tre pikë pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

**6. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “COMPANY RIVIERA 2008” sh.p.k & “BAJRAMI N.” sh.p.k**

**NUIS K81716011V & NUIS K02727202O**

Vlera: 303,241,845.00 (treqind e tre million e dyqind e dyzet e një mijë e tetëqind e dyzet e pesë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

**7. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “CURRI” sh.p.k & “MELA.” sh.p.k**

NUIS J67902718S & NUIS K62320011G

Vlera: 307,543,416.60 (treqind e shtatë million e pesëqind e dyzet e tre mijë e katërqind e gjashtëmbëdhjetë pikë gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH.

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

**8. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “S.M.O.UNION” sh.p.k & “FLED” sh.p.k & “SITA PARTNERS” sh.p.k**

NUIS J66902042Q & NUIS K17621104C & NUIS L42027005K

Vlera: 308,715,804.00 (treqind e tetë million e shtatëqind e pesëmbëdhjetë mijë e tetëqind e katër) lekë pa TVSH

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

**9. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “LIQENI VII” sh.p.k & “AMEL INVEST” sh.p.k**

NUIS K01730502W & NUIS L32005501M

Vlera: 324,190,303.50 (treqind e njëzet e katër million e njëqind e nëntëdhjetë mijë e treqind e tre pikë pesëdhjetë) lekë pa TVSH

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

**10. Operatori Ekonomik “ALBA KONSTRUKSION” sh.p.k** NUIS J61812013R

Vlera: 338,315,143.61 (treqind e tridhjetë e tetë million e treqind e pesëmbëdhjetë mijë e njëqind e dyzet e tre pikë gjashtëdhjetë e një) lekë pa TVSH

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

**11. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “PE – VLA - KU” sh.p.k & “BIBA-X” sh.p.k**

NUIS K61716013M & NUIS K32618815N

Vlera: 357,831,071.85 (treqind e pesëdhjetë e shtatë million e tetëqind e tridhjetë e një mijë e shtatëdhjetë e një pikë tetëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

**12. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “EUROTEOREMA PEQIN” sh.p.k & “BEQIRI” sh.p.k**  
NUIS J61905050M & NUIS J98624801V

Vlera: 382,142,735.38 (treqind e tetëdhjetë e dy million e njëqind e dyzet e dy mijë e shtatëqind e tridhjetë e pesë pikë tridhjetë e tetë) lekë pa TVSH

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

### **1. Dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik “ALBAVIA” sh.p.k**

- Pas kontrollit rezultoi se oferta e operatorit ekonomik “ALBAVIA” sh.p.k është me cmim anomalisht të ulët. Referuar nenit 82 pika 4, të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” (e ndryshuar), parashikohet se: *“...Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve....”*.

### **2. Dokumentacioni i paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “EUROKOS HOLDING SH.P.K DEGA NE SHQIPERI” sh.p.k & “A.L-ASFALT” sh.p.k**

- Operatori ekonomik “A.L-ASFALT” shpk nuk permbush Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.3, ku percaktohet se: “Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik (Inxhinier Ndertimi) të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt...”. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit, rezultoi se operatori ekonomik “A.L-ASFALT” shpk ka deklaruar drejtues teknik të punimeve punonjës me iniciale V.T, i cili rezulton i angazhuar me kohë të plotë në kontratën me objekt: “Rehabilitim i rruges “Liçeni i Thate””, lidhur me Autoritetin Kontraktor Bashkia Tiranë, e cila i vazhdon efektet ligjore-teknike dhe financiare.

### **3. Dokumentacioni i paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “BE-IS” sh.p.k & “ERGI” sh.p.k & “RRUGA URA ASFALTIM NR.2 ELBASAN” sh.a**

- Operatori ekonomik “BE-IS” shpk nuk permbush Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.16 gërma h , ku percaktohet se: *“Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tiranë, afati i zbatimit të cilave nuk ka përfunduar përbëjnë shkak skualifikimi”*. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit, rezultoi se operatori ekonomik “BE-IS” shpk ka deklaruar mjete të cilat janë të angazhuara në kontratën me objekt: *“Ndertim i rruges Zall Bastar/Vilëz”*, lidhur me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tiranë, si më poshtë:

- Autobot uji me targë me targë AB731JV;
- Grejder me targë: ARMT78;
- Kamioncinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton me targë AB130CZ ;
- Kamioncinë me kapacitet mbajtës 3.5 deri në 10 ton me targë AB194VU;
- Autobitumatrice me targë AA782FA;
- Makineri për vizime në rrugë me fature tatimore shitje nr.21, date 05.11.2008.

- Operatori ekonomik “ERGI” shpk nuk permbush Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.16 gërma h), ku percaktohet se: *“Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tiranë, afati i zbatimit të cilave nuk ka përfunduar përbëjnë shkak skualifikimi”*. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit, rezultoi se operatori ekonomik “ERGI” shpk i ka deklaruar mjete të cilat janë të angazhuara në kontratën me objekt: *“Ndertim i rruges Zall Bastar/Vilëz”*, lidhur me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tiranë, si më poshtë:

- Asfaltoshtruese me targë AMMT63;
- Grejder me targë AAMT 46;
- Autobitumatrice me targë AB772AR
- Autobot uji me targë me targë EL1401C;
- Kamion me kapacitet mbi 10-20 ton me targë AA211VS
- Rul (Kompresor)me Vibrim me Nr.Shasie CAT00323VHDT00204
- Rul (Kompresor)me Vibrim me Nr.Shasie 900525001
- Ekskavator me goma me targë AB 917 BY
- Makineri për vizime në rrugë me fature tatimore shitje nr.22, date 30.06.2003
- Gazogjen me fature tatimore shitje nr. 845, date 10/05/2018

#### **4. Dokumentacioni i paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “AGRI CONSTRUCTION” sh.p.k & “K A C D E D J A” sh.p.k**

- Operatori ekonomik “Kacdedja” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.16 gërma h , ku percaktohet se: *“Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tiranë, afati i zbatimit të cilave nuk ka përfunduar përbëjnë shkak skualifikimi”*. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit, rezultoi se operatori ekonomik “Kacdedja” shpk ka deklaruar mjetin Autobitumatrice me targë TR0344L, i cili rezulton mjet i angazhuar në kontratën me objekt *“Rikualifikim urban i zonës “Kodra e Diellit” – Faza II ”* lidhur me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tiranë.

- Operatori ekonomik “Kacdedja” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, pika 2.3.13, ku percaktohet se: *“Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet (elektrike, tuba, bojra). Per materialet e kerkuara OE duhet te paraqese katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe te paraqiten çertifikatë/deklaratë konfirmimit CE, certifikatat e cilesise ose raportet e testimit nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara ne Specifikimet teknike”*. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit, rezultoi se bashkimi i operatorëve ekonomikë ka paraqitur autorizim prodhuesi të lëshuar për artikujt e bojës nga kompania “Dorjan” shpk, i cili nuk përputhet me skedat përkatëse teknike ku prodhues është shoqëria ALCEA. Operatori ekonomik ka paraqitur dhe çertifikatën teknike për bojrat Zmalto, dokument ku citohet se *lëndët me të cilat përgatiten bojrat e zmalto janë të prodhuara nga firma prestigjose në Europë si AKZONOBEL, CHEMIPOL DCC*, cka bie në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.13 të Kriterëve të Vecanta të Kualifikimit, në dokumentet standarde të tenderit.

- Operatori ekonomik “Agri Construction” shpk nuk përmbush kërkesat për punën e ngjashme pasi nga kontratat e paraqitura për të vërtetuar punën e ngjashme vetëm kontrata me objekt *“Rikualifikimi Urban i Bllokut kufizuar nga rruga “Mine Peza” – “Fortuzi” “Zogu I-rë” – “Haxhi Hysen Dalliu” – “Asim Vokshi”* e realizuar në vlerën 159,846,949.91 lekë pa tvsh, është punë e ngjashme me objektin e prokurimit, ndërsa kontratat e tjera të paraqitura kanë objekt të ndryshëm nga objekti i kësaj procedure prokurimi dhe për rrjedhojë nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.1 gërma a), ku percaktohet se: *“Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: 222,696,071.66 (dyqind e njëzet e dy milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëdhjetë e një pikë gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”*.

## 5. Dokumentacioni i paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “B93 II” sh.p.k & “ELMAZAJ KONSTRUKSION” sh.p.k & “ASI-2A CO” sh.p.k

- Operatori ekonomik “B93 II” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.1 gërma a) dhe b), ku percaktohet se për: *“Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: 222,696,071.66 (dyqind e njëzet e dy milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëdhjetë e një pikë gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

*Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: 890,784,286.66 (tetëqind e nëntëdhjetë milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e katër mijë e dyqind e tetëdhjetë e gjashtë pikë gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH.....”* Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit, rezultoi se operatori ekonomik “B93 II” Shpk, për plotësimin e përvojës së ngjashme ka paraqitur disa kontrata, ndër të cilat kontratat me objekt “Mbrotja e lumit të Vermoshit”, “Mbrotja e lumit Shushicë”, “Rehabilitimi i kanalit ujitës KU-15, Kurbin, L = 11 Km”, “Rikonstruksioni i fasadave të objekteve përgjatë lumit Drin në qytetin e Lezhës, Blloku nr.1 dhe rruga Lalm i Ri, Naim Frashëri”, nuk janë punë të ngjashme me objektin e prokurimit.

Operatori ekonomik “B93 II” Shpk ka paraqitur dhe kontratat me objekt: “Ndërtim i rrjetit rrugor dhe infrastrukturës urbane të zonës Lezhë, Njësia Administrative, Lëzhë”, për të cilën nuk është paraqitur marrëveshje e bashkëpunimit midis operatorëve ekonomik, dhe kontratën me objekt “Zona e re për zhvillim në Spitallë, rikonstruksioni i rrugëve “Miqësia” dhe “Azem Hajdari”, Loti II, rruga “Miqësia”, Nj.a Spitallë, Bashkia Durrës”, për të cilën mungon Çertifikatë e marrjes në dorëzim dhe Marrëveshje e Bashkëpunimit ndërmjet operatorëve ekonomik.

Operatori ekonomik “B93 II” Shpk ka paraqitur dhe kontratat me objekt: “Rruga e Malësorëve” me vlerë 46,562,355 lekë pa tvsh, “Rikualifikimi i rrugë Niko Hoxha” me vlerë 23,341,784.33 lekë pa TVSH, “Ndërtimi rruga Shkodra + Pingul me rrugën Jon + Rruga e re + segm Pingul me rrugen Gjirokastra, Valias”, me vlerë 39,686,450 lekë pa TVSH, “Rehabilitimi i ndricimit të akseve rrugore, Durrës” me vlerë 11,950,744 lekë pa TVSH, të cilat janë punë të ngjashme me objektin e prokurimit, por nuk përmbushin kërkesat e përcaktuara sipas germës a) dhe b) të pikës 2.3.1, të Kriterëve të Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, Dokumenteve standarte të tenderit lidhur me vlerën e kërkuar.

Nga verifikimi rezulton se ndarja e punimeve sipas marreveshjes së bashkëpunimit nuk përputhet me deklarin në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

Sipas Sistemit të Prokurimit Elektronik, operatori ekonomik B93II shpk ka marrë përsipër të realizojë 11% të punimeve, Operatori ekonomik ELMAZAJ KONSTRUKSION ka marrë përsipër të realizojë 34% të punimeve, Operatori ekonomik ASI-2A CO ka marrë përsipër të realizojë 55% të punimeve.

Referuar marreveshjes së bashkëpunimit mbi ndarjen në përqindje të punimeve ndërmjet operatorëve ekonomikë rezulton se: Operatori ekonomik “B93II” shpk ka marrë përsipër të realizojë 34% të punimeve, Operatori ekonomik “ELMAZAJ KONSTRUKSION” shpk ka marrë përsipër të realizojë 55% të punimeve, Operatori ekonomik ASI-2A CO ka marrë përsipër të realizojë 11 % të punimeve.

## 6. Dokumentacioni i paraqitur Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “CURRI” sh.p.k & “MELA.” sh.p.k

- Operatori ekonomik “MELA.” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.3, ku percaktohet se: *“Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik (Inxhinier Ndertimi) të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt...”*. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit, rezultoi se operatori ekonomik “MELA.” shpk ka deklaruar drejtues teknik të punimeve

punonjësin me initiale E.M, i cili rezultoi i angazhuar me kohë të plotë në kontratën me objekt: *“Rikualifikimi i bllokut të tregu Çam”* lidhur me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tiranë, kontratë e cila i vazhdon efektet ligjore-teknike dhe financiare.

## **7. Dokumentacioni i paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “S.M.O.UNION” sh.p.k & “FLED” sh.p.k & “SITA PARTNERS” sh.p.k**

- Bashkimi i operatoreve ekonomik “SMO UNION” shpk & “FLED” shpk & “SITA PARTNERS” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.10, ku përcaktohet se: “Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, një dokument që vërteton kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/diplomë), lëshuar nga institucione shtetërore apo private të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore... 1 (një) Teknik Elektrik- 1 (një) Teknik Topograf...”, pasi nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetëdeklarimit rezultoi se asnjë nga anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomik nuk ka deklaruar punonjësit Teknik elektrik dhe punonjësin Teknik topograf, cka bie në kundërshtim me kërkesën e përcaktuar në Dokumentet e Tenderit, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.10.

- Operatori ekonomik “SITA PARTNERS” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.11, ku përcaktohet se: “Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjes si më poshtë: 3 (tre) Punonjës automakinist...” gërma (a) ku përcaktohet se “Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik si dhe operatorët mbështetës të deklaruar nga operatorët pjesëmarrës si subjekt mbështetës duhet të deklarojnë për punonjësit e mesipër emrin/mbiemrin, profilin e punës, numrin e kontratës individuale të punës, numrin e dëshmisë së aftësisë profesionale dhe afatin e vlefshmërisë së saj...”. Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, rezultoi se operatori ekonomik “SITA PARTNERS” nuk ka deklaruar të dhënat si numri i dëshmisë dhe afati i vlefshmërisë së aftësisë profesionale për punonjësin automakinist, cka bie në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.11, Kapaciteti Teknik, të Dokumenteve të Tenderit.

- Operatori ekonomik “SMO UNION” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.16, ku përcaktohet: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund të vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) ....” gërma (g) ku përcaktohet; “Për mjetet që sipas përcaktimeve ligjore të qarkullimit rrugor nevojiten targa, leje qarkullimi...etj. Operatori ekonomik duhet të deklarojë në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në rubrikën përkatëse të dhënat për mjetet e kërkuara në shtojcën 8...”. Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetëdeklarimit rezultoi se operatori ekonomik “SMO UNION” shpk në përmbushje të kërkesës për disponim të mjetit Autobotmatrice ka deklaruar mjetin kamion me bitumatrice, cka bie në kundërshtim me kërkesat e pikës 2.3.16, të Kapacitetit Teknik, Kriteret të Vecanta të Kualifikimit, të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

- Operatori ekonomik “FLED” shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.14, ku përcaktohet se: “Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat ISO.... Çertifikatën e menaxhimit të energjisë SSH/DIN/EN/UNI 50001-2018 (e vlefshme) ose ekuivalente, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, Operatori ekonomik që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit do të marrë përsipër realizimin e zërave elektrikë të Preventivit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO ose ekuivalente...”. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit, rezultoi se operatori ekonomik “FLED” Shpk nuk ka paraqitur Çertifikatën ISO 50001, cka bie në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në pikën 2.3.14, Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pasi sipas marrëveshjes së bashkëpunimit dhe ndarjes së elementëve të preventivit, Operatori ekonomik “FLED” shpk ka marrë përsipër realizimin e punimeve elektrike për segmentin 4A.

- Operatori ekonomik "SITA PARTNERS" shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.14, ku përcaktohet se: "Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat ISO.... Çertifikatën e menaxhimit të energjisë SSH/DIN/EN/UNI 50001-2018 (e vlefshme) ose ekuivalente, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, Operatori ekonomik që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit do të marrë përsipër realizimin e zërave elektrikë të Preventivit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO ose ekuivalente...". Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit, rezulton se operatori ekonomik "SITA PARTNERS" shpk nuk ka paraqitur Certifikatën ISO 50001, cka bie në kundërshtim me Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.14, pasi sipas marrëveshjes së bashkëpunimit dhe ndarjes së elementëve të preventivit, operatori ekonomik "SITA PARTNERS" shpk ka marrë përsipër realizimin e punimeve elektrike për segmentin 4A.

#### **8. Dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik "ALBA KONSTRUKSION" sh.p.k**

- Operatori ekonomik "Alba Konstruksion" shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.16 gërma h , ku përcaktohet se: "*Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, do të jenë të angazhuara vetëm në këtë kontratë. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tiranë, afati i zbatimit të cilave nuk ka përfunduar përbëjnë shkak skualifikimi*". Nga verifikimi i mjeteve të deklaruara në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, rezultoi se operatori ekonomik "Alba Konstruksion" shpk ka mjete të cilat janë të angazhuara në kontratën me objekt "*Rehabilitimi i fasadave & rrugës Luigj Gurakuqi deri tek sheshi Avni Rustemi (me parkim 2 kate nën tokë)*", lidhur me Bashkinë Tiranë, si më poshtë:

- Kamioncinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton me targë AA169RP;
- Kamion me kapacitet mbajtës 10 - 20 ton me targë TR5032S;
- Asfaltoshtruese me deklarate doganore R.43649, date 02.07.2009;
- Grejder me deklarate doganore R.30489, date 24.06.2011;
- Rul (Kompresor)me Vibrim me deklarate doganore R.4146, dt.23.01.2009;
- Vibrator me fature tatimore shitje nr. 928, dt. 01.11.2016;

#### **9. Dokumentacioni i paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë "PE – VLA - KU" sh.p.k & "BIBA-X" sh.p.k**

- Operatori ekonomik "BIBA-X" shpk nuk përmbush Kriteret e Vecanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 2.3.3, ku përcaktohet: "*Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklarate Drejtuesin Teknik (Inxhinier Ndertimi) të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt...*". Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit, rezultoi se operatori ekonomik "BIBA-X" shpk ka deklaruar drejtues teknik të punimeve punonjës nën iniciale B.Th, i cili rezultoi i angazhuar me kohë të plotë në kontratën me objekt: "*Rehabilitimi i Infrastruktures rrugore në Njësinë Administrative Nr.11 + Zall Herr*" lidhur me Autoritetin Kontraktor, Bashkia Tiranë, kontratë e cila i vazhdon efektet ligjore-teknike dhe financiare.

---

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se **Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë "COMPANY RIVIERA 2008" sh.p.k & "BAJRAMI N." sh.p.k**, NIPT K81716011V & NIPT K027272020 dhe me adresë: "Rruga Nacionale Kamez-Fushe Kruje, Kthesa e Valiasit Nr.1, në zonë



kadastrale 2066, Nr. Pasurie 62/38, Kamez Tirane” & “Labinot fushe Xibrake, rruga Elbasan-Xibrake km. 13, zk.3864, pasurite nr.734/1+732+738/9, Elbasan”, me vlerë totale prej: 303,241,845.00 (treqind e tre million e dyqind e dyzet e një mijë e tetëqind e dyzet e pesë) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.